



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1575/2 prot.,

Datë 14.06.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK
ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI SKUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË
TJERË

Objekt:

Shfuqizim i Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga Bashkimi i operatorëve ekonomikë “ULZA” SHPK & “PEPA GROUP” SHPK & “ALMO KONSTRUKSION” SHPK dhe Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimit teknik të paraqitur nga Bashkimi i operatorëve ekonomikë, në procedurën e prokurimit “E Hapur - punë publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me Nr. REF-99889-04-02-2024, me objekt: “Rikonstruksion i rrugës së vjetër Kombinat - Ndroq - Plepa, Loti I”, me fond limit **754,965,352.17** (shtatëqind e pesëdhjetë e katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e pesëdhjetë e dy pikë shtatëmbëdhjetë) **Lekë pa TVSH. Në Euro: 7,354,036.16** (shtatë milion e treqind e pesëdhjetë e katër mijë e tridhjetë e gjashtë pikë gjashtëmbëdhjetë) **Euro pa TVSH**, zhvilluar në datën 08.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “A.N.K” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “COBIAL” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “ULZA” SHPK & “PEPA GROUP” SHPK & “ALMO KONSTRUKSION” SHPK me Nipt J67902928O, L42215009L, J91915001P me adresa: Njësia bashkiake nr. 5, rruga Zef Jubani, ndërtesa 15, hyrja 19, ap 1, kodi postar 1019, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Rrugor Shqiptar.
Adresa: “Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë.

Subjekt i interesuar:

Operatori ekonomik “A.N.K” SHPK me NIPT J92408001N dhe adresë Tiranë, Rruga e Kavajës, Pallatet Condor, Kulla 1, Hyrja e parë, kati i tretë.

Operatori ekonomik “COBIAL” SHPK me NIPT K02715414M dhe adresë Tiranë, Rruga "Milito Tutulani", Ndërtesa nr.2, H. 19, në Zonën Kadastrale Nr.8270, me Nr. Pasurie 5/336- N16.

Në datën 13.06.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2024/4211 dhe me nr. 1575/2024 prot, datë 13.06.2024 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ULZA” SHPK & “PEPA GROUP” SHPK & “ALMO KONSTRUKSION” SHPK për procedurën e prokurimit “*E Hapur - punë publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike*”, me Nr. REF-99889-04-02-2024, me objekt: “Rikonstruksion i rrugës së vjetër Kombinat - Ndroq - Plepa, Loti 1”, me fond limit **754,965,352.17** (shtatëqind e pesëdhjetë e katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e pesëdhjetë e dy pikë shtatëmbëdhjetë) **Lekë pa TVSH. Në Euro: 7,354,036.16** (shtatë milion e treqind e pesëdhjetë e katër mijë e tridhjetë e gjashtë pikë gjashtëmbëdhjetë) **Euro pa TVSH**, zhvilluar në datën 08.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “ULZA” SHPK & “PEPA GROUP” SHPK & “ALMO KONSTRUKSION” SHPK dhe Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimit teknik të paraqitur nga Bashkimi i operatorëve ekonomikë, në procedurën e prokurimit.

Gjithashtu, edhe me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, lidhur me vlerësimin me pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “A.N.K” SHPK dhe operatori ekonomik “COBIAL” SHPK, të cilët nuk përmbushin kriteret e vendosura për kualifikim të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërmat “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”*

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “ULZA” SHPK & “PEPA GROUP” SHPK & “ALMO KONSTRUKSION” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

“Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Ulza & Pepa Group & Almo Konstruksion ” sh.p.k pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST , konkretisht; → Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Puna e ngjashme e realizuar gjatë pesë viteve të fundit, e paraqitur nga operatori “Pepa Group” nuk e plotëson vlerën sipas përqindjes pjesmarrëse në kontratën e bashkëpunimit.

Gjithashtu, operatori “Almo Konstruksion” nuk përmbush kriterin 2.3.4 “Stafin mbështetës” pasi, staf mbështetës i vetdeklaruar në shtojcën 8, është i angazhuar në një kontratë në proces pranë Autoritetit Kontraktor, kjo në kundërshtim me pikën 2.3.4 ku thuhet; “Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese””.

Bazuar në nenin 112 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë kriterin e vlerësimit dhe objektin e pretendimeve që bashkimi i operatorëve ekonomikë “ULZA” SHPK & “PEPA GROUP” SHPK & “ALMO KONSTRUKSION” SHPK, parashtron në ankesën me nr. 1557/2024 prot., datë 12.06.2024.

“Referuar Dst vlerësimi i pikëve dhe mënyra e përlllogaritjes së tyre mbetet i paqartë dhe i pa argumentuar çka i lë hapësira për AK që të interpretojë vetë mënyrën e përlllogaritjes së pikëve, për këtë arsyeje kemi pretendime që Vlerësimi i pikëve nuk ka qenë i drejtë dhe për këtë kërkojmë transparencë në mënyrën se si është bërë përcaktimi i secilit prej kriterëve dhe mënyra e përlllogaritjes.

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

Çmimi pikët 50

Grafiku i punimeve dhe metodologjia pikët 15

Stafi / Organizimi i Kompanisë pikët 15

Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social pikët 10

Periudha e garancisë dhe mirëmbajtjes rutinë të objektit pikët 10

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomisht më të favorshme bazuar në kosto

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1, 2.a, 5) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.b ,3, 4) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

1. Çmimi [50 pikë]

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{kl} = V_{\min kl} \times P_{\max kl} / O_{kl}$$

P_{kl} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min kl}$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max kl}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{kl} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

2. Grafiku i punimeve dhe metodologjia [15 pikë]

Operatori ekonomik mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori duhet të argumentojë (në mënyrë përshkimore dhe grafike) kohën e propozuar (jo më shumë se 24 muaj). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nënkritereve.

Nënkriteri:

a) Grafiku i punimeve të Kontratës [10 pikë]

**Shënim: Operatori ekonomik për të justifikuar propozimin e këtij nënkriteri duhet të paraqesë minimalisht analizën e makinerive që do angazhojë operatori ekonomik për secilin proces dhe numrin e përafërt të punonjësve të angazhuar për çdo proces*

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2a} = V_{\min k2a} \times P_{\max k2a} / O_{k2a}$$

P_{k2a} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k2a}$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k2a}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k2a} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

b) Faktorë favorizues / pajisje inovative / metodologji punimesh që favorizojnë kohën e realizimit të punimeve [5 pikë]

3. Staf i / Organizimi i kompanisë [15 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga staf kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin 2.3 / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

a. *Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencë në fushën specifike [13 pikë]*

**Shënim: Vlerësimi i këtij nënkriteri do të realizohet sipas përcaktimeve më poshtë:*

I. Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kritereve të veçanta të kualifikimit për stafin [1 pikë]

II. Dëshmi që stafi disponon kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

III. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

IV. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit. [6 pikë]

Për përmbushjen e kritereve të mësipërme duhet të dorëzohet CV dhe dëshmi/reference/dokumentacion të lëshuar nga punëdhënësi të mëparshëm ose përfituesit.

b. *Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [2 pikë]*

**Shënim: Për përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori ekonomik duhet të dorëzojë organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjisë të ndërveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikëqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor/Entin. Avantazh përbëjnë sistemet e brendshme të kontrollit dhe menaxhimit të cilësisë.*

4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [10 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / eficiente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [5 pikë]
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zonës ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [5 pikë]

5. Periudha e garancisë dhe mirëmbajtjes rutinë të objektit [10 pikë]

Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm:

- a) Periudha e garancisë së punimeve civile / pajisjeve (jo më pak se 2 vite) [5 pikë]

Kjo, në mbështetje të Udhëzimit Nr. 3, datë 15.2.2001 “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”.

Pikët për këtë nënkriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = V_{\min k5} \times P_{\max k5} / O_{k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k5}$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

- b) Periudha e mirëmbajtjes rutinë në përputhje me periudhën e garancisë [5 pikë]

Pikët për këtë nënkriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = V_{\min k5} \times P_{\max k5} / O_{k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k5}$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Shënim: Operatori ekonomik pjesëmarrës për vlerësimin me pikë për këto dy nënkritere duhet të vetëdeklarojë se do të kryejë edhe mirëmbajtjen rutinë gjatë periudhës së garancisë.

Të gjithë dokumentacionet me propozime të përshkruara nga operatori ekonomik në plotësim të kritereve të mësipërme të vlerësimit do të reflektojnë kushtet e kontratës (për të përfshirë propozimin konkret), duke mos implikuar asnjë kosto shtesë mbi vlerën e ofertuar për realizimin e punimeve të kontratës (sipas Shtojcës nr. 1), për shkak të propozimeve të mësipërme.

OSE

B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □

Në rastin e marrëveshjes së kuader, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të cmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së cmimeve për njësi (Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore kur sasitë janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar).

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikon pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ULZA” SHPK & “PEPA GROUP” SHPK & “ALMO KONSTRUKSION” SHPK që të skualifikohen operatorët ekonomikë “A.N.K” SHPK dhe “COBIAL” SHPK, për mospërbushjen e kritereve nga ana e secilit, si më poshtë vijon:

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërbushjen e kritereve si më poshtë vijon:

2.3.4 *Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:*

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili Infrastrukturë e Transport)
- 1 (një) Inxhinier Topograf / Gjeodet/ Markshajder
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog / Gjeoteknik
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

- ❖ *Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.*

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Nr</i>	<i>Lloji i makinerive</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Statusi</i>
1	<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton</i>	<i>Copë</i>	6	<i>Në pronësi ose me qira</i>
2	<i>Kamionçinë</i>	<i>Copë</i>	2	<i>Në pronësi ose me qira</i>
3	<i>Kamion me vinç</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Në pronësi ose me qira</i>
5	<i>Greider</i>	<i>Copë</i>	2	<i>Në pronësi ose me qira</i>
6	<i>Autobot uji</i>	<i>Copë</i>	2	<i>Në pronësi ose me qira</i>
7	<i>Autobetoniere</i>	<i>Copë</i>	3	<i>Në pronësi ose me qira</i>
8	<i>Autopompë betoni</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Në pronësi ose me qira</i>
9	<i>Autobitumatriçe</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Në pronësi ose me qira</i>
10	<i>Asfaltoshtruese</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Në pronësi ose me qira</i>
11	<i>Eskavator me goma</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Në pronësi ose me qira</i>
12	<i>Makineri për vendosje guardrail</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Në pronësi ose me qira</i>
13	<i>Eskavatorë me zinxhirë</i>	<i>Copë</i>	2	<i>Në pronësi ose me qira</i>
14	<i>Minieskavator</i>	<i>Copë</i>	2	<i>Në pronësi ose me qira</i>
17	<i>Rul gomë-hekur</i>	<i>Copë</i>	2	<i>Në pronësi ose me qira</i>
18	<i>Rul gomë-gomë</i>	<i>Copë</i>	2	<i>Në pronësi ose me qira</i>
19	<i>Rul hekur-hekur</i>	<i>Copë</i>	2	<i>Në pronësi ose me</i>

				<i>qira</i>
21	<i>Minifadromë</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
22	<i>Makineri vijëzimi me bojë termoplastike (sprajt)</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
23	<i>Fabrikë betoni (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B)</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi</i>
24	<i>Fabrikë asfalti (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B)</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi</i>
25	<i>Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B)</i>	<i>Copë</i>	<i>1</i>	<i>Në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi</i>

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: certifikatën e pronësisë; lejen e qarkullimit; certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; lejen e transportit që lëshohet nga njësia vendore dhe fotot përkatëse;
Ndërsa për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.*
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.*
- Për impiantin e asfaltit, të betonit dhe nyjen e inerteve duhet të paraqiten kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fotot ose fatura tatimore përkatëse, lejen mjedisore lëshuar nga QKL. Nëse është marrë me qira/furnizim, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/furnizimit. Operatori ekonomik për fabrikën e asfaltit, të betonit dhe nyjen e inerteve mund të paraqesë edhe kontratë të vlefshme furnizimi me operatorë ekonomikë. Në këtë rast, duhet të paraqesë kontratën e furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton ekzistencën dhe pronësinë e impiantit, si dhe lejen mjedisore kodi III.1.B lëshuar nga QKL.*
- Për mjetet që transportojnë mjete të rënda duhet të paraqitet certifikata përkatëse e lëshuar nga institucioni kompetent.*

- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- *Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar ne procedura te shpallura fitues.*

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 14.06.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar

Anëtar

Fiorent Zguro

Anila Malaj

Kryetar

Jonaid Myzyri